

URDHËR
Nr.413, datë 25.8.2011

**PËR SHPËRNDARJEN E KUOTAVE TË PRANIMIT PËR PROGRAMET E STUDIMIT
TË CIKLIT TË PARË, ME KOHË TË PLOTË, PËR KANDIDATËT NGA REPUBLIKA
E KOSOVËS, SI DHE KANDIDATËT SHQIPTARË NGA MAQEDONIA, MALI I ZI,
PRESHEVA, BUJANOVCI DHE MEDVEGJA NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË
ARSIMIT TË LARTË, VITIT AKADEMIK 2011-2012”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 33 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të pikës 4, vendimit nr.423, datë 8.6.2011, të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimit në institucionet publike të Arsimit të Lartë, cikli i parë i studimeve me kohë të plotë, si dhe tarifat e shkollimit për vitin akademik 2011-2012”, të ndryshuar

URDHËROJ:

1. Kuotat e pranimit për kandidatët nga Republika e Kosovës, si dhe kandidatët shqiptarë të Maqedonisë, Malit të Zi, Preshevës, Bujanovcit dhe Medgjevës për programet e studimit të ciklit të parë, kohë e plotë, viti akademik 2011-2012, të cilat pasqyrohen, në total për çdo program studimi, në kolonën E, të tabelës nr.1, të vendimit nr.423, datë 8.6.2011 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimit në institucionet publike të Arsimit të Lartë, cikli i parë i studimeve me kohë të plotë, si dhe tarifat e shkollimit për vitin akademik 2011-2012”, të ndryshuar, të shpërndahen sipas tabelës nr.1, bashkëngjitur këtij urdhri.

2. Administrimi i aplikimeve dhe përzgjedhja e kandidatëve nga Republika e Kosovës, si dhe kandidatëve shqiptarë të Maqedonisë, Malit të Zi, Preshevës, Bujanovcit dhe Medvegjës bëhet nga Institucionet Publike të Arsimit të Lartë pritëse mbështetur në notën mesatare të shkollës së mesme edhe notat e lëndëve për të cilat Institucionet Publike të arsimit të Lartë kanë vendosur koeficientët më të lartë për pranimet në këtë vit akademik.

3. Kandidatët fitues, sipas programeve të ndryshme të studimit, midis aplikantëve nga Republika e Kosovës, si dhe kandidatëve shqiptarë të Maqedonisë, Malit të Zi, Preshevës, Bujanovcit dhe Medvegjës, të përcaktuar nga Institucionet Publike të Arsimit të Lartë, sipas udhëzimit nr.25, datë 20.7.2011 “Për procedurat e pranimit dhe të regjistrimit në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë në institucionet publike të arsimit të lartë për vitin akademik 2011-2012”, shpallen në përputhje me kuotat e shpërndara sipas tabelës nr.1, bashkëngjitur këtij urdhëri.

4. Institucionet Publike të Arsimit të lartë, deri në datën 25 shtator 2011, të dërgojnë kuotat e parealizuar nga regjistrimet e kandidatëve fitues, në mënyrë që Ministria e Arsimit dhe Shkencës të bëjë rishpërndarjen e tyre.

5. Institucionet Publike të Arsimit të Lartë që zhvillojnë konkurse pranimi për të gjitha ose disa programe studimi të ciklit të parë, me kohë të plotë, të pranojnë për konkurrim aplikantë nga trojet shqiptare jashtë vendit, edhe në rastet kur ndonjëra prej trojeve nuk ka kuotë të përcaktuar në tabelën nr.1, bashkëngjitur këtij urdhri.

6. Ngarkohen Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor dhe Institucionet Publike të Arsimit të Lartë për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT
Myqerem Tafaj